

INTERNET BANKING PYETJET ME TE SHPESHTA

Pyetjet me te Shpeshta ne lidhje me Internet Banking te Intesa Sanpaolo Bank Albania

Contents

1. Si mund të filloj ta përdor Internet Banking?	2
2. Cfarë browseri kërkohet për të aksesuar Internet Banking?	2
3. Cfarë Versioni Browseri duhet të përdor për të pasur një pamje të qartë të Internet Banking?	2
4. Cfarë duhet të bëj përpara se të aksesoj Internet Banking?	2
5. Cfarë lloj transaksionesh bankare mund të kryhen përmes Internet Banking?	2
6. Mund ti vendos një emërtim llogarisë/ve te mia?	3
7. A mund të ndryshoj Fjalëkalimin tim?	3
8. Si mund të kërkoj një Fjalëkalimin të ri?	3
9. Sa kohë mund të jem jo aktiv para se sesioni im i Internet Banking të skadojë automatikisht?	3
10. Cfarë ndodh nëse unë harroj ose humbas Fjalëkalimin tim	3
11. A është i sigurt Internet Banking?	4
12. Cilat lloj produktesh bankare do mund të aksesoj përmes Internet Banking?	4
13. A mund ti paguaj faturat përmes Internet Banking?	4
14. A mund të krijoj dhe mirëmbaj përfitues përmes Internet Banking?	4
15. A mund të ndryshoj gjuhën në Internet Banking?	4
16. Cfarë duhet të bëj nëse Përdoruesi im bllokohet?	4
17. Çfarë duhet të bëj në rast të vjedhjes apo mashtrimit të identitetit online?	4
18. Cfarë është Celësi i Sigurisë?	5
19. Si mund ta përdor Celësin e Sigurisë?	5
20. A ka ndonjë komision për përdorimin e Celësit të Sigurisë?	5

INTERNET BANKING

1. Si mund të filloj ta përdor Internet Banking?

Thjesht vizito një nga Degët me të afërta të Intesa Sanpaolo Bank Albania për të aplikuar për shërbimin dhe për të marrë të gjithë kredencialet e nevojshme (Emrin e përdoruesit, Fjalëkalimin dhe Celësin e Sigurisë)

2. Cfarë browseri kërkohet për të aksesuar Internet Banking?

Nuk kërkohet asnjë Sistem/Program për të aksesuar Shërbimin e Internet Banking të Intesa Sanpaolo Bank Albania. Gjithcka që ju nevojitet është një kompjuter dhe lidhje Interneti. Web browser-at e mëposhtëm janë të rekomanduar për tu futur në Internet Banking:

- ✓ *Internet Explorer*
- ✓ *Mozilla Firefox*
- ✓ *Google Chrome*

3. Cfarë Versioni Browseri duhet të përdor për të pasur një pamje të qartë të Internet Banking?

Versionet e Browserave që duhet të përdorni janë:

- ✓ *Internet Explorer 11*
- ✓ *Mozilla Firefox duke filluar nga 45.7.0*
- ✓ *Google Chrome duke filluar nga version 56.0.2924.87 '64-bit'*

4. Cfarë duhet të bëj përpara se të aksesoj Internet Banking?

Përpara se të aksesoni Internet Banking duhet të bëni Clear Cache. Instruksionet se si bëhet Clear Cache mund ti gjeni në faqen e përzgjedhjes së gjuhës, në pjesën e sipërme djathtas të ekranit.

5. Cfarë lloj transaksionesh bankare mund të kryhen përmes Internet Banking?

Nëpërmjet Internet Banking të Intesa Sanpaolo Bank Albania, ju mund të:

- ✓ *Monitoroni gjithë llogaritë që keni ne Intesa Sanpaolo Bank Albania;*
- ✓ *Kontrolloni balancën e llogarisë/ve tuaja;*
- ✓ *Transferoni para në monedha të ndryshme midis llogarive tuaja personale që keni pranë Intesa Sanpaolo Bank Albania;*
- ✓ *Transferoni fonde në cdo llogari brënda Intesa Sanpaolo Bank Albania ose në llogari të tjera brënda dhe jashtë Shqipërisë, duke i autorizuar transaksionet me Celësin tuaj të Sigurisë;*
- ✓ *Krijoni listën e përfituesve tuaj të preferuar për përdorim të shpejte;*
- ✓ *Hapni Depozita me Afat;*
- ✓ *Shikoni gjëndjen e Depozitave tuaja egzistuese;*
- ✓ *Shikoni gjëndjen e Kredive dhe Overdraftëve tuaja egzistuese;*
- ✓ *Shprehni interesin tuaj për ofertat e personalizuar që ju shfaqen;*
- ✓ *Aksesoni produktet dhe shërbimet e ofruara nga Banka dhe shprehni interesin tuaj për ato që ju nevojiten;*
- ✓ *Kontrolloni online njoftimet tuaja, gjëndjen e llogarive dhe Ceqet e lëshuara;*

- ✓ *Shikoni kursin e fundit të këmbimit valutor dhe këmbeni monedha të shumta duke përdorur përlllogaritësin e kursit të këmbimit.*

6. Mund ti vendos një emërtim llogarisë/ve te mia?

Po, ju mund ti vendosni një emërtim llogarisë/ve tuaja, Depozitave me Afat, dhe Kredive, në menunë "Përcaktoni Llogaritë e Preferuara". Klikoni në seksionin "Emërtimi Llogarisë" në krah të djathtë të Numrit të Llogarisë dhe vendosni emërtimin që keni zgjedhur.

7. A mund të ndryshoj Fjalëkalimin tim?

Po ju mund të ndryshoni Fjalëkalimin tuaj në cdo kohë në seksionin "Ndrysho Fjalëkalimin" në pjesën e sipërme të Internet Banking. Për të ndryshuar Fjalëkalimin së pari ju duhet të fusni Fjalëkalimin tuaj të vjetër në mënyrë korrekte. Pas kësaj ju duhet të përcaktoni Fjalëkalimin tuaj të ri. Fjalëkalimi juaj i ri duhet të plotesojë kërkesat si me poshtë:

- ✓ *Minimumi gjatësisë 8 karaktere;*
- ✓ *Maksimumi i gjatësisë 16 karaktere;*
- ✓ *Duhet të përfshijë shkronja të mëdha, shkronja të vogla dhe karaktere të vecanta;*
- ✓ *Nuk ka ndonjë kufizim specifik të përcaktuar karakteresh Për llojet e karaktereve të listuara me sipër.*

8. Si mund të kërkoj një Fjalëkalimin të ri?

Për të marrë një Fjalëkalim të ri, kontaktoni Qendrën tonë të Thirrjeve në një nga numrat e mëposhtëm:

- ✓ *08006000 (numër falas);*
- ✓ *+355 4 22 76 000;*
- ✓ *+ 355 (0) 692080903;*

ose shkoni në një nga degët më të afërta të Intesa Sanpaolo Bank Albania.

9. Sa kohë mund të jem jo aktiv para se sesioni im i Internet Banking të skadojë automatikisht?

- ✓ *Koha e skadimit është vendosur 30 minuta automatikisht (pas hyrjes në qoftë se ju nuk kryeni asnjë transaksion). Pas 30 minutave të pasivitetit sesioni juaj do të përfundojë dhe t'ju nxjerri automatikisht.*
- ✓ *Kohëzgjatja e caktuar që përdoruesit ti skadoje sesioni i shërbimit Internet Banking edhe kur është aktiv (ka kryer veprime) është 1 orë e 6 minuta.*

10. Cfarë ndodh nëse unë harroj ose humbas Fjalëkalimin tim.

Shko në një nga degët më të afërta të Intesa Sanpaolo Bank Albania për të kërkuar një Fjalëkalim të ri.

11. A është i sigurt Internet Banking?

Po, Internet Banking është i sigurt. Internet Banking është i mbrojtur nga një teknologji sigurie mjaft e lartë. Asnjë informacion personal i identifikueshem, si përshembull numri juaj i llogarisë nuk do të ruhet në paisjen tuaj.

12. Cilat lloj produktesh bankare do mund të aksesoj përmes Internet Banking?

Ju mund të aksesoni cilëndo llogari, kredi apo depozitë që ju keni kërkuar të lidhet me shërbimin Internet Banking. Ju mundeni që në cdo kohë të shtoni në këtë shërbim, llogari të reja që mund të hapni, thjesht duke dërguar një email përmes shërbimit të postës elektronike të Internet Banking ose duke vizituar degën tuaj.

13. A mund ti paguaj faturat përmes Internet Banking?

Po, pagesa e faturave është e vlefshme përmes Internet Banking. Ju mund të paguani faturat e secilit faturues që është i disponueshëm në listën e faturuesve. Ju lutem vëreni se përpara se të kryeni ndonjë pagesë fature, ju duhet fillimisht të regjistroni faturuesin që kërkohet në seksionin përkatës.

14. A mund të krijoj dhe mirëmbaj përfitues përmes Internet Banking?

Po, në Internet Banking ju jeni në gjendje të krijoni, ndryshoni dhe fshini përfitues si për transfera brënda bankës ashtu edhe për transfera jashtë bankës.

15. A mund të ndryshoj gjuhën në Internet Banking?

Po, ju mund të ndryshoni gjuhën në faqen përkatëse përpara se të aksesoni Internet Banking.

16. Cfarë duhet të bëj nëse Përdoruesi im bllokohet?

Përdoruesi juaj do të bllokohet automatikisht pas futjes gabim të fjalëkalimit/celësit të sigurisë 3 herë rradhazi. Për të zhblokuar përdoruesin tuaj, vizitoni një nga degët tona ose kontaktoni me Qendrën tonë të Thirrjeve në numrat e mëposhtëm:

- ✓ 08006000 (numër falas);
- ✓ +355 4 22 76 000;
- ✓ + 355 (0) 692080903.

17. Çfarë duhet të bëj në rast të vjedhjes apo mashtrimit të identitetit online?

Për të raportuar ndonjë mashtrim ose vjedhje në lidhje me produktet tuaja bankare, ju lutem kontaktoni me Qendrën tonë të Thirrjeve në numrat e mëposhtëm:

- ✓ 08006000 (numër falas);
- ✓ +355 4 22 76 000;
- ✓ + 355 (0) 692080903.

18. Cfarë është Celësi i Sigurisë?

Celësi i Sigurisë është një pajisje portative që gjeneron një fjalekalim një përdorimësh (OTP). OTP përdoret për të autorizuar transaksionet e përcaktuara dhe pagesat e kryera përmes Internet Banking duke ju siguruar një element shtesë sigurie.

19. Si mund ta përdor Celësin e Sigurisë?

Shtypni butonin OK të Celësit të Sigurisë. Futni numrin 6-shifror që gjenerohet nga Celësi i Sigurisë, në faqen hyrëse të Internet Banking (kur do të logoheni në sistem) ose në faqen përkatëse të autorizimit të veprimit (kur po kryeni një transaksion) dhe më pas shtypni butonin "OK".

20. A ka ndonjë komision për përdorimin e Celësit të Sigurisë?

Po, ka një komision fillestar në momentin që aplikon për Celësin e Sigurisë në përputhje me [Kushtet e Punes](#) së bankës.